

TRECIM

LETËRSI E VEÇANTË PËR KOHËN QË NJERËZIT MUNDOHEN VETËM TA ANATEMOJNË DHE KËTË HERË NGA NJË PREJ AUTOREVE MË TË NJOHURA SLLAVE TË KOHËS SONË. ME NJË PENË SHUMË TË KËNDSHME DHE ME NJË IRONI TË LEHTË, KU NUK MUNGON DASHURIA PËR JETËN, AUTORJA NA JEP NJË SEGMENT TË PAHARRUAR TË KOHËS SONË...

SI IA HODHEM KOMUNIZMIT,

NGA SLAVENKA DRAKULIÇ*

Përktheu: Mirela Kumbaro

Për t'i parë më mirë Vesna ngriti getat nga drita, rrëshqiti brenda tyre dorën për t'i kontrolluar, hapi gishtat e më pas, dalëngadalë, i nxori jashtë duke kërkuar ndonjë fije të hequr. Njëra prej këmbëve ishte në rregull, ndërsa tek tjetra gjeti një fije të ikur. "Këto janë bërë për t'u hedhur", - tha me vete duke i vënë mënjane dhe nga grumbulli që kishte përpara mori një palë të tjera. Ishim ulur në kuzhinën e saj, një mëngjes të diele plot dritë. Kisha shkua t'i kërkoja për pak fshesën me korrent, pasi e imja, pikërisht atë ditë kishte vendosur t'i jepte fund ekzistencës së saj të gjatë e të frytshme. E ulur në anën tjetër të tryezës, e ëma zgjati dorën dhe mori getat e lëna mënjane: "Gjynah moj Vesna, këto geta mund t'i mbash akoma, në shtëpi. I çoj unë për t'i qepur". Vesna i hodhi një vështrim mospajtues, pastaj ia plasi të qeshurit. "Jo, hiqe nga mendja", i tha dhe ktheu sytë nga unë. "Sa herë që dua të hedh ndonjë palë geta poshtë, kjo përpigjet t'i shpëtojë", i çon për t'i qepur, i përdor për të mbushur jastëkë, për të lidhur qesen e plehrave ose për të kulluar lëngjet; gjithmonë gjen dhjetëra mënyra për t'i futur përsëri në punë çorapet ose getat e vjetra. Kujton se jemi akoma në vitet pesëdhjetë. E ëma rruftiste qetë-qetë kafënë, duke tundur kokën, thua se sado që të përpigjet ajo ne s'mund ta kuptonim. "Nuk jemi në vitet pesëdhjetë, po si dihet se ç'ndodh. Harrove që s'gjeje geta në dyqan para nja dy vjetësh? Ndërsa ti më kërkoje të të ndreqja ato të vjetrat, ato që kisha 'shpëtuat' unë. T'i qepa me një fije najloni, duke u futur brenda një elektrik të vjetër dore (shqyq Zotit që e kisha ruajtur, se sa inat më vjen që hodha poshtë vezën e vjetër prej druri që e përdorja për të zënë fijen e çorapeve). Ç'më thua, të hedh poshtë një palë geta vetëm se iu ka ikur një fije..."

U thashë se nuk e dija që kishte akoma riparim çorapësh: tani getat prodhoheshin në mënyrë industriale megjithëse të ne kushtonin shtrenjtë. Kësisoj mësova se kishte ende një çorapeqepëse e cila kishte mbyllur dyqanin dhe punonte në shtëpi. U përpooja ta përfytyroja, të ulur me llambën përpara dhe me makinën qepëse të vogël si prej kullash. Ndoshta është tu ajo që banonte në Maksimirska ulica ku unë shkoja dikur, një herë në muaj, me një shportë plot me çorape për të riparuar. "Ke kohë të presësh?", më pyeste, duke e ditur se i kisha gati një palë që i kishte "iukur vetëm një fije" dhe që doja t'i merrja me vete. Duhet të kishin kaluar më shumë se njëzet vjet asokohe çorapet e holla ishin të rralla e të kush-tueshme dhe mund t'i hidhje vetëm pasi t'i kishte riparuar shumë herë. "Pa shiko tani!", vazhdoi nëna e Vesnes, "ku i dihet, nga një çast në tjetrin mund të shpërthejë lufta civile: serbët kundër kroatëve, çekët kundër sllovakëve, hungarezët kundër çifutëve. E si mund të jesh e sigurt?" Por Vesna ngriti zërin: "Moj mama, po të ndodhin të gjitha këto që thua ti, kujt do t'i bjerë në mend të shkojë të marrë çorapet që ka cuar për të qepur në dyqan!"

"Çuditësh ti, bijë e dashur, që njerëzit duhet të mendojnë se si të jetojnë dhe të mbijetojnë edhe në kohë lufte. Le që, si ta ha mendja ty se mbijetuan në komunizëm ne?" - ia ktheu e ëma. Me të vërtetë, si kemi bërë? Sigurisht jo duke hedhur të gjërat e nevojshme. Në përgjithësi, në asnjë vend komunist nuk kish-të shumë sende që mund të hidheshin poshtë. Madje mund të thuhet se ekonomia shtëpiake komuniste është shembulli thuasje i përkryer i unitetit ekologjik, vetëm se kjo ekologji ka një origjinë krejt tjetër: nuk vjen si rrjedhojë e shqetësimit për natyrën që shkaktohet nga një lloj i veçantë frike për të ardhmen. Ky unitet ekologjik si dhe çdo lloj tjetër uniteti, bazohet



Vdekja e Titos

mbi parime themelore: mbledhja dhe riciklimi. ripërdoret, riciklohet, përsëri përdoret, duke përkufizuar sërish një send (në këtë rast getat), duke i kthyer në diçka tjetër, duke i ndryshuar funksionet njëri pas tjetrit dhe hidhet poshtë vetëm pasi jemi siguruar (nëpërmjet përvojës) se nuk mund të përdoret më në asnjë lloj mënyre tjetër. Për të bërë një riciklim ashtu siç duhet, domethënë të dobishëm, duhet ditur më parë se çfarë të mbledhësh. Mbledhja e gjërave varet kryesisht nga përvoja e ndryshme në vende të ndryshme komuniste ose më saktë nga shkallët e ndryshme të varfërisë. Në vija të trasha mund t'i grupojmë si më poshtë: sende të dobishme në përgjithësi (copa të vjetra, këpucë, elektroshtëpiake, mobilje, tenxhere, kanistra, fshesa e gazeta); sende që zakonisht njerëzit normalë në vende normale i hedhin poshtë (që me fjalë të tjera shërbejnë për të mbajtur a ruajtur lloj-lloj gjërash: shishe, kavanoza, filxhanë, kanoçe, tapa e shtupa, llastikë, qese plastike, letër ambalazhi, kuti kartoni); sende të huaja (lloje lloje e nga gjithfarë vendesh: lapsa e fletore, veshje, çamçakëz, letra karamalesh); sende që mund të zhduken (grup shumë i gjerë e i larmishëm që përmblidh miell, kafë, vezë, ilaç rrobash, sapun, geta, vida, gozhde, spango, tel elektrik, parfum, bllok shënimesh, libra; nuk i dihet, nuk mund ta parashikosh se çfarë mund t'i shtosh listës tjetër e pikërisht për këtë arsye duhet ruajtur). Fakt është se në qoftë se në vende perëndimore jo shumë të pasur, vetëm të varfrit mbledhin e riciklojnë sende pak a shumë sipas mënyrës sonë, në Evropën Lindore ishim kaq të varfër sa që të gjithë detyroheshim të vepromin nëvojë. Të gjithë jetonim vazhdimisht me mungesa të mëdha, duke mos ditur se ç'do të gjenim të nesërmen në dyqan.

Unë laja dyshemenë e shtëpisë time me një palë benevrecke të vjetër burrash, pa e kuptuar se sa qesharake ishte të ngulje një palë brekë në shkopin e dyshemesë, dhe këtë e bëja derisa një ditë një shoqja ime (natyrisht, e huaj) ma vuuri në dukje duke qeshur. Njësoj si nëna e Vesnes, mendoja se ishte gjynah t'i hidhje poshtë kur mund t'i pagëzoja përsëri si leckë për të larë dyshemenë. Se blen dot një leckë? më pyeti shoqja ime. Si se bleja, po pse ta bleja? Edhe gjyshja ime kështu bënte, edhe mamaja po ashtu; le që, deri në fund të viteve 60 ku ishte parë të shiteshin leckat për dyshemenë në dyqan? Përvoja e gjatë ka treguar se ndërresat e brendshme prej pambuku kanë një aftësi fantastike për të marrë pluhurat dhe për të pas-truar dyshemenë, dritaret, pllakat e kështu me radhë, kaq e vërtetë është kjo sa që nëna ime

vazhdon të ndjekë të njëjtën metodë.

Aty e kuptova që mikësia ime nuk dinte asgjë për rrobat e ricikluara: triko të bëra me lesh të shqepur, pallto të vjetra të kthyer nga ana tjetër dhe të përshtatura për fëmijët, ose një çarçaf i ri që qepje duke prishur dy të vjetër. Ajo nuk e dinte se në "ekologjinë e varfërisë" asgjë nuk shkon kot e aq më pak rrobat, që zakonisht nuk u jepen të tjerëve (mos janë gjë më poshtë se ty) ose vetëm arxhinjve. Njerëzit mund të fihen kur u tregon se duke pasur veshje të reja je më i pasur se të tjerët. Por para se t'i përdorim për qëllime të tjera (ky është hapi i dytë) i mbajmë ato si "tropa për në shtëpi". Dikush që s'është mësuar, duke hyrë në ndonjërin prej shtëpive tona do të gjendej përballë një pamjeje të çuditshme e megjithatë të rëndomtë, të një njeriu të respektuar, madje edhe të rëndësishëm (një profesor në universitet, për shembull), të veshur me pizhama me vija, në një pulover të vjetër të ngrenë nga mola e të arnuar me lesh të një ngjyrë tjetër, me shapka të vjetra e me një penjuar të rrjepur. Duke qenë se ky "koleksionizëm" është një sport kombëtar askujt s'i bëhej vonë të paraqitej i sajuar në një mënyrë kaq absurde. Kushtet e jetesës vrasin çdo lloj intimiteti, ose, po t'ju pelëqej ndryshe, ia bëjnë atë të ditur gjithë bashkësi. Apartamentet janë shumë të vogla e të ngjeshura pas njëri tjetrit, ose me shumë ndarje, në të gjitha shtëpitë është e pamundur të mos ndeshësh me tjetrin kur shkon në banjë apo në kuzhinë. Njësisia familjare komuniste nuk mund t'i sigurojë të gjitha gjërat vetë dhe për pasojë ajo varet fatalisht nga komshinjtë tek të cilët kërkon borxh sheqer ose kafë, t'i japë një dorë për të larë rrobat ose për të bërë punët e shtëpisë, ndihmë për të regjistruar djalin në një shkollë më të mirë ose diskuton për politiken e mallkuar. Kësisoj komshiu ose komshia juaj do t'ju sho-

hë patjetër me rrobat "e shtëpisë". Mbese këtu ka edhe një anë të mirë, nuk krijohen iluzione të gabuara për njërin apo për tjetrin. Megjithëse logjika e ruajtjes dhe e riciklimit të rrobave të vjetra është e qartë, është e vështirë për atë që nuk jeton afër një vendi komunist të kuptojë pse hiqen mënjane disa sende që janë bërë enkas për t'u hedhur. Për shembull, pse duhet ruajtur një kuti e vjetër këpucësh? Kur i ke blerë e i ke sjellë këpucët në shtëpi mund ta hedhësh kutinë pa pikë ngurrimi. E pra, një kuti e mirë dhe e fortë mund të ketë shumë përdorime; njerëzit e mbajnë në fund të dollapit ose mbi komo në dhomën e gjumit. Po t'i kërkon dikujt t'ju tregojë fotografitë e familjes, ai nuk do t'ju sjellë një album, por një kuti këpucësh të pluhurosur të cilës do t'i heqë me kujdes gjalmën me të cilën e kishte lidhur sikur kjo kuti të mbante diçka të çmuar, një copë një kuti e tij, diçka që nuk duhet parë çdo ditë. Arsyja e kutisë është e thjeshtë: për shumë kohë s'ka pasur albume në treg, dhe kur kishte kushtonin shumë shtrenjtë. Përveç kësaj duket se këtu njerëzit nuk kanë shumë fotografi, edhe ato që kanë nuk i shohin ose nuk ua tregojnë aq shpesh të tjerëve. Kutitë e këpucëve janë të mira edhe për të ruajtur faturat, sidomos ato të vjetrat, edhe të dhjetë vjetëve, njëzet vjetëve të shkuaara, madje edhe më shumë. Faturat e ujit, të gazit, të dritës, faturat e qirasë, të kursimeve...kur ke të bësh me një burokraci aq të shtrirë e të pazonjën, është më mirë ta kesh mundësinë për t'u kthyer prapa në vite për të provuar pafajësinë tënde. Një kuti këpucësh është si një kompjuter, mbushur me të dhëna të grumbulluara me rregull, të domoshme për të mbijetuar në një sistem që ka për qëllim të shkatërrtojë individin.

Në çdo shtëpi përparësinë absolute e ka mbledhja e banozave prej qelqi, ma ha



MADJE DUKE QESHUR



Beograd

mendja megenese në to mund të vendosësh sende të tjera. Edhe në këtë rast, gjëja më normale në botë, pasi ta kesh mbaruar marmalatën ose turshinë, do të ishte ta hidhje kavanozin; dhe në se është e mundur në një kohë të caktuar për grumbullimin e mbeturinave prej qelqi. Mirëpo s'ndodh kështu: për të vetmen arsye se tek ne zbulohet shpejt një mënyrë tjetër riciklimi; gjithmonë gjendet diçka për ta futur brenda: një grusht me gozhdë të ndryshkura, vida njëshe (që s'i gjen në dyqanin e hekurishteve kur i do) kopsa, llastikë (pasi janë hequr nga paketimet), tapa të ndryshme, brisqe rroje të vjetër (s'i dihet, mund të vijë një ditë që të zhduken në treg) copa sapuni, spango (kush e di si vjen puna), bukë të tharë e të grirë, kafe e pabluar; hudhra të njoma, ose edhe turshi të bëra në shtëpi. Në kavanozat e mëdhenj mbahen ushqime që ruhen në vende të freskëta, në ballkon gjatë dimrit, si të ishin në frigorifer: një shpikje tjetër praktike. Po qe se thyhet ndonjë kavanoz, kapaku i tij përdoret si tavell duhani: këtu të gjithë pijnë duhan e tavllat s'mjaftojnë asnjëherë!

Pjesa më e madhe e njerëzve ruajnë kutitë prej teneqeje, sidomos ato të mëdhatë, por as të voglat nuk hidhen poshtë. "Gjynah t'i hedhësh" thoshte shpesh një komshija ime e moshuar, e kësajsoj mbillte më shumë se dymbëdhjetë kanoçe me rruka të kuqe dhe i vendoste në ballkon. Në hyrje të shtëpisë, nëpër shkallë, në banjë. Kam përshtypjen se grave iu pëlqejnë më shumë teneqet me ngjyrë të verdhë se ato të argjendta: duken më mirë në ballkone e parvaze, nëpër oborre, madje edhe brenda në shtëpi, kudo ku mund të vihen. Merrret një kuti teneqeje, një gozhdë dhe një çekiq: kthehet kutia mbrapsht e i bëhet një vrimë me gozhdë dhe me çekiq dhe ja ku është gati: ke bërë kështu, thuhajse nga hiçi, një vazo të re.

Kjo quhet ekologji. Një lule mund të rritet edhe në një tigan ose në një legen të vjetër, sidomos nga ata me ngjyrë të kuqe ose blu e me pika të bardha. Në sajë të këtij sistemi lulet e qytetit që mungesa e diellit i bën raktike, marrin një çikë gjallëri. Natyrisht, kjo ndodh nëse mund t'ia lejojsh vetes të mbash të tilla vazo luksoze si tiganët e vjetër, se zakonisht këta përfundojnë nën lavamanë për të mbajtur qepë e patate. Qëllon që të dalin në dritë një herë në vit kur zbardhet kuzhina me gëlqere ose ndonjë dhomë tjetër (në anë tona këtë punë e bëjmë ende vetë), me këtë rast ata shndërrohen përsëri në enë për të mbajtur bojën. "Sot e kësaj dite s'heq dot dorë nga zakoni i larjes së vazove të vogla plastike të kosit" më thotë Vesna. "Nga mesi i viteve gjashtëdhjetë, kur filloi prodhimi i tyre (më përpara kosi shitej në kavanoza qelqi që duheshin kthyer), unë shkoja ende në shkollë dhe i përdorja për bojërat e ujit. Në shtëpi vajzat e vogla luanin me to si të ishin enë të vogla ose i përdornin për të vënë kripen apo shegerin. Tani, megjithëse s'më duhen më, prapë i ruaj, një Zot e di pse. Them se sot për sot ruajtja e sendeve të tilla pasqyron më shumë një status mendor se sa një nevojë reale. Mbledhim gjëra se kemi frikë nga e ardhmja; është shumë më e thellë nga sa e mendjoja. Fjalët e saj më kujtuan një tjetër lloj grumbullimi: makutërinë me të cilën koleksionojta, kur isha e vogël, letrat e karamelëve dhe të cokollatave, që më jepte një shok i klasës babai i të cilit jetonte jashtë. I shtrija midis faqeve të një libri, i kundroja, duke e mbajtur vështrimin mbi fjalët e huaja si framboise ose sucre ose chocolatier, dhe ndjeja erën që kishite lënë përmbajtja e tyre e shijshme dhe ekzotike por që unë nuk e kisha provuar kurrë. Ndërsa "jashtë shtetit" (një kategori njerëzish në ato kohë kuptonin çdo gjë që ndodhej përtej kufijve pa asnjë dallim), ambalazhonin çdo

karamelle me një letërzë të mrekullueshme, tek ne kishite vetëm një lloj karamelleje që quhej 505 sa crtom, të futura në një kuti të metalte ngjyrë rozë ato dhuroheshin zakonisht për Vitin e Ri (jo për Krishtlindje). Kjo s'ka pse t'ju habisë, sepse në atë kohë, në fillim të viteve pesëdhjetë, kishite vetëm një fabrikë karamelësh që kishite marrë emrin e heroit të luftës Josip Kras.

Është e natyrshme që të mrekulloheshim pa atyre letërzime shumëngjyrëshe: ato përfaqësonin kontaktin tonë të parë me jashtë, na jepnin ndjesinë se përveç tyre, atje, tej kufijve tanë, ekzistonte diçka më e panjohur dhe e dëshirueshme. Më tutje filluan të koleksiononim lloj-lloj etiketash të huaja ëmbëlsirash, birrash, djathrash, veshjesh; e pastaj paketa cigaresh importi, kanoçe birrash, shishe coca-cola që turistët hidhnin në det kur prisnin traqetin. Mjaft që të ishin të huaja. Përse? Sepse çdo gjë që vinte nga jashtë ishte më e bukur dhe më tërheqëse, që nga letrat e karamelëve deri në kanoçet e birrës, dhe është e natyrshme që ashtu siç ishin ne të rrethuar nga varfëria, të tërhiqeshim nga ajo bota tjetër që dallonte dukshëm nga e jona. Shumë e shumë kohë më pas (ndoshta tepër vonë) mësuam se ishte konsumizmi, një mënyrë mjaft e zhvilluar për të tërhequr blerësit. Por s'besoj se arritëm të bindeshim, vazhdojmë edhe sot e kësaj dite të koleksionojmë me pasion sende të huaja, sikur kërkim të zotërojmë ende atë mitin e "së jashtëm", imazhin e saj. Është një ndjesi shumë familjare për ne: më kujtohet vetja ime kur isha pesë vjeç e merrja në banjo të kuqin e buzëve të mamasë, nxirrja nga goja çamçakizin e bëja me pak të kuq dhe e përzieja derisa të ngjyroset i tëri; pastaj dilja jashtë dhe përpara shoqeve të mija bëja gjoja sikur ishte çamçakëz original i markës "Bazooka Joe" (ndonëse e kisha provuar vetëm njëherë në jetën time, dhe vetëm një copëz të vogël), për t'u ngjallur atyre zilinë, por duke shpresuar se asnjëra nuk do të më kërkente t'i tregojta vizatimet e vogla që duhet të gjendeshin në letërën e brendshme të mbështjelljes (vizatime që unë vetë s'i kisha parë ndonjëherë), me personazhe që flisnin me retë në gjuhën e panjohur të hënës.

Gjyshja ime ka vdekur në vitet shtatëdhjetë, pasi kaloi nga dy muaj në spital. Në këtë kohë nëna përfitoi për t'i pastruar dollapin dhe sirtarët nga "rraqurinat", siç thoshte ajo; gjyshja ime ishte e famshme për të mbledhur e ruajtur çdo gjë që ia zinte syri. Se ç'mbante brenda dollapi i rëndë prej dru lisi

merrej me mend: pallto të vjetra (mua më pëlqente më shumë një jeshile, e qepur dikur midis dy luftrave, që kishite një etiketë prej mëndafshi me mbishkrimin: Modeëerkstatte Franziska Bundschuh), një pelice prej asragani të rrjepur që vinte erë naftalinë, shumë palë këpuce, doreza, një pîrg me çarçafë të bëra me dorë thuhajse të reja dhe më në fund fustanka e pagëzimit të nënës sime. Pastaj kishite një musandër që në të vërtetë shërbente si një depo e vogël e mbushur si një anije të cilës i duhet të bëjë një lundrim në ujëra të panjohura. Ishte plot me ilaç rrobash të grumbulluar kohë pas kohe e që ishte ngurtësuar i tëri: shishe me vaj të prishur; disa kile sheqer; miell e kafe (me një fjalë artikujt më elementarë për jetesë); disa pako me çaj, biskota, makarona; konservava me salcë domatesh (gjyshes time i pëlqente shumë kuzhina italiane), fasule, madje edhe nja dy kile kriepë, megjithëse s'di të ketë njeri që të thotë se kjo e fundit ka munguar ndonjëherë. Ushqimet ishin ngjeshur të tëra në raftet e poshtme, ndërsa në ato të sipërmet kishite ç'të të donte zemra; një rrotull me tyl të bardhë, lëmshe leshi me ngjyra të ndryshme, corape e geta të reja e të qepura (ndonjëra prej tyre me siguri që duhet të datonte që para Luftës së Dytë Botërore) bojë flokësh e zezë dhe kafe, shampo, sapunë të vegjël, krem duarsh, letër higjienike, ilaçe të skaquara - antibiotikë, aspirina, insulina (ndonëse asnjë nga familja ime s'vuante nga diabeti) si dhe tableta të tjera të paviditifikueshme - dhe më në fund pambuk dhe pesë a gjashtë paketa me piceta higjienike. Po ta shohësh mirë, musandra e gjyshes time më shumë se sa një magazinë i ngjante një muzeu të gjithçkaje që na kishite munguar në komunizëm.

Por e papritura e vërtetë s'kishite ndodhur akoma. Kur hapëm njerin prej sirtarëve mbetëm me të vërtetë të shtangur, megjithëse edhe ne ishim mësuar të ruanim gjëra. Sirtari ishte plot e përplot me qese plastike, të lara, të thara, të ndara në grupe e të lidhura me llastikë. Lloje lloje e ngjyra ngjyra. Ato më të mëdhatë vinin nga magazinat e mëdha të huaja ose nga dyqanet e famshme ku kishim shkuar njëzet vjet më parë kur udhëtonim në Austri, Gjermani, Itali, Spanjë ose Suedi, pastaj kishite të tjera më të vogla që vinin nga dyqanet e Zagrebit, më të vjetin qeset normale pa mbishkrime dhe në fund ato më të voglat. Si një arkeologje e vërtetë, gjyshja kishite krijuar një koleksion që dokumentonte zhvillimin dhe përdorimin e qeseve plastike që nga momenti kur ato filluan të hyjnë në vendin tonë, kur u përmirësuan standartet e jetesës (qeset jepeshin falas), gjatë krizës ekonomike (ato u zhdukën nga qarkullimi) e deri sot kur duhet t'i paguash. Disa miq që kishin qenë në Bashkimin Sovjetik na thoshin se ato qeset plastike ishin shumë në modë, sidomos ato me mbishkrime dhe më të vërtetë atje gratë i mbanin si çanta. Këtë ne nuk e bënim por nga ana tjetër lanim qeset e përdorura dhe gjenim gjithmonë një mënyrë për t'i ripërdorur derisa përfundonin në plehra (si qese për të mbajtur plehrat natyrisht). Them se sirtarët e gjyshes time tregojnë jo vetëm se si ia kemi hedhur komunizmit por edhe pse falimentoit komunizmit: falimentoit për shkak të mosbesimit, të frikës nga e ardhmja. Është e vërtetë, njerëzit mblidhnin gjëra nga varfëria. Ishte një lloj varfërie disi e veçantë, një varfëri ku të gjithë uanin se iu mungonte diçka, pra të gjithë ishin të varfër, një varfëri ku të qenurit të varfër dhe nevojtar ishte një mënyrë jetese që nuk mund të ndryshonte lehtë, as fjalët, deklaratat, premtimet ose kërcënimet e politikanëve nuk e ndryshonin dot. Dhe më e rëndësishmja është se mblidhja dhe ruajtja ishte një domosdoshmëri, pasi askush nuk besonte deri në fund në një sistem i cili kishite treguar se ishte i paaftë për të përballuar kërkësat themelore të qytetarëve për më shumë se dyzet vjet. Ndërsa udhëheqësit grumbullonin fjalë për një të ardhme të ndritur, njerëzit grumbullonin sheqer e miell, kavanoza të vegjël të mëdhenj, geta, bukë bajate, tapa, gozhdë, qese plastike. Sikur politikanët të kishin pasur mundësinë të hidhnin një sy brenda musandrave, dollapëve e sirtarëve tanë, në vend të librave të ndaluar apo materialeve kundër shtetit, do të shikonin se cila ishte e ardhmja që po deponitohej për projektet e tyre të mrekullueshme të komunizmit. Por ata nuk i hodhën ndonjëherë sytë aty brenda.

*Shkrimtare dhe gazetare kroate. Autore e librit "Ballkan Ekspres"



Zagreb